

PËRMBAJTJA E UDHËZIMIT

A. HYRJE	4
I. KUSHTE TË PËRGJITHSHME	4
II. PROCEDURA	4
1. KU MUND TA MERRNI FORMULARIN "KËRKESË"?	4
2. NDIHMË GJATË PLOTËSIMIT TË FORMULARIT	4
3. DORËZIMI I FORMULARIT TË PLOTËSUAR	4
4. AFATI PËR PARASHTRIM TË KËRKESËS	5
III. PAGIMI I MJETEVE FINANCIARE	9
IV. PËRLLOGARITJA E PËRKRAHJES FINANCIARE	9
V. PËRKRAHJE FINANCIARE PLOTËSUESE.....	9
ME RËNDËSI PËR PERSONAT QË RUAJNË BAGËTI TË TRASHA, DELE DHE DHI!!!	10
B. PRODHIMTARIA BIMORE	11
I. BUJQËSIA	11
1.1 Përkrahje financiare sipas sipërfaqeve që punohen me kultura bujqësore	11
1.2 Përkrahje financiare plotësuese për sipërfaqe të mbjella me drithëra nga nënpika 1.1. me farë të certifikuar.....	12
II. KOPSHTARIA	13
1.3 Përkrahje financiare plotësuese për sipërfaqe të mbjella me kultura të kopshtarisë	13
1.4 Përkrahje financiare plotësuese për prodhimtari nën kushte të kontrolluara (domate, piperka, trungje dhe lule të krasitura) nga nënpika 1.3, në vitin 2010.....	14
1.5 Përkrahje plotësuese financiare për prodhimet e kopshtarisë që në vitin 2010 janë dhënë në ndonjë nga kapacitetet përpunuese sipas nënpikës 1.3	15
III. VRESHTARI DHE PEMËTARI	16
1.6. Përkrahje financiare sipas sipërfaqeve për mirëmbajtje të vreshtave ekzistuese, të evidentuara në regjistrin e vreshtave deri më 30.11.2010	16
1.7. Përkrahje financiare sipas sipërfaqes për mirëmbajtje të pemishteve ekzistuese (përveç për sipërfaqet e paraqitura që janë mbjellë me mollë sipas nënpikës 1.15)	17
1.8 Përkrahje financiare për mbjelljet e reja të vreshtave të evidentuara në regjistrin e vreshtave deri më 30.11.2010	18
1.9. Përkrahje financiare për mbjellje të sipërfaqeve të reja me pemë	20
IV. PRODHIM TË MATERIALEVE PËR MBJELLJE DHE TË FARAVE	21
1.11 Përkrahje financiare për prodhim të farave të certifikuara vendase për drithëra, kultura industriale (përveç duhanit) dhe të kopshtarisë	21
1.12 Përkrahje financiare për prodhim të kalemit shtëpiak për vreshta dhe fidanë pemësh.....	22
1.13 Përkrahje financiare për prodhim dhe përpunim të farës shtëpiake dhe të certifikuar të duhanit	22
V. PAGESA TË VEÇANTA	23
1.14. Përkrahje financiare për analizat agrokimike dhe pedologjike të tokës të realizuara në vitin 2010	23
1.15. Përkrahje financiare sipas sipërfaqes për mirëmbajtje të sipërfaqeve me mollë	24

C. PRODHIMTARIA BLEGTORALE	25
I. RITJE GJEDHESH.....	25
2.1 Përkrahje financiare për kokët e bagëtive të evidentuara	25
2.2 Përkrahje financiare për qumështin e lopëve të prodhuar dhe të shitur.....	25
2.3 Përkrahje financiare për gjedhet e ruajtura dhe të therura në ndonjë nga kapacitetet therëse të regjistruara	26
2.4 Përkrahje financiare për çdo viç të fituar me anë të P/A.....	27
2.5 Përkrahje financiare për blerje të mëshqerrave pjellore me prejardhje të njohur dhe me potencial të madh gjenetik.....	27
II. BLEGTORI.....	28
2.6 Përkrahje financiare për numrin e deleve të evidentuara nga të gjitha kategoritë.....	28
2.7 Përkrahje financiare për blerje të bagëtive pjellore-origjinale dhe për shumim	29
III. RITJA DHE RUAJTJA E DHIVE	30
2.8 Përkrahje financiare për dhitë e evidentuara.....	30
2.9 Përkrahje financiare për blerje të cjapeve për shumim	30
IV. RITJA DHE RUAJTJA E DERRAVE.....	31
2.10 Përkrahje financiare sipas numrit të dosave.....	31
2.11 Përkrahje financiare për derrat e ruajtur dhe të therur në ndonjë nga kapacitetet therëse	32
2.12 Përkrahje financiare për blerje të dosave pjellore.....	32
V. AVIKULTURË.....	33
2.13 Përkrahje financiare për zogjtë e rritur dhe të therur në kapacitete të regjistruara therëse.....	33
2.14 Përkrahja financiare për pula që nuk japin vezë ë therura në kapacitetet e regjistruara therëse.....	34
2.15 Përkrahje financiare për zogjtë njëditorë	34
2.16 Përkrahje financiare për zogjtë femra njëditorë nga hibridët që japin vezë.....	35
VI. BLETARI.....	35
2.17 Përkrahje financiare për familjet e regjistruara të bletëve që e kanë kaluar dimrin.....	35
2.18 Përkrahje financiare për blerje të mbretëshave.....	36
2.19 Përkrahje financiare për hapje të sipërfaqeve të reja në vende ku mund të grumbullohet mjalti (vende me barëra që japin shumë mjaltë, rogoveckë)	37
VII. BLEGTORIA ALTERNATIVE.....	37
2.20 Përkrahje financiare për ruajtje të strucëve në ferma.....	37
2.21 Përkrahje financiare për rritjen e kërmijve në ferma.....	38
D. STANDARDE PËR SIGURI DHE KUALITET	39
I. REGJISTRIM DHE FITIM I TË DREJTËS PËR SHENJË GJEORAFIKE (SHGJ), SHENJË PËR PREJARDHJEN (SHP) DHE SHENJË PËR SPECIALITET TRADICIONAL (ST)	39
3.1 Përkrahje financiare për kompensim të shpenzimeve prodhuese sipas prodhimeve të mbrojtura me prejardhje shtazore dhe bimore	39
3.2 Përkrahje financiare për përdoruesit e emrit të mbrojtur gjeografik	40
3.3 Përkrahje plotësuese financiare për prodhim të lëndës së parë për prodhime bujqësore ushqimore me emër të mbrojtur gjeografik.....	40
3.4 Përkrahje financiare për përgatitje të elaboratit për mbrojtje të emrit gjeografik të prodhimeve dhe përpunimeve të caktuara bujqësore.....	41
3.5 Përkrahje financiare për kontroll dhe certifikim të emrit të mbrojtur gjeografik të prodhimeve dhe përpunimeve të caktuara gjeografike.....	42
3.6 Përkrahje financiare për regjistrim në regjistrin ndërkombëtar për mbrojtje të emrit gjeografik.....	43
3.7 Përkrahje financiare për realizim të fushatës për promovim të prodhimeve bujqësore-ushqimore maqedonase, duke e mbrojtur emrin e tyre gjeografik në tregun vendas dhe të huaj	43
3.8 Përkrahje financiare për etiketim dhe shënim të prodhimeve me emër të mbrojtur gjeografik dhe të specialiteteve tradicionale	44
II. STANDARDE PËR SIGURI NË PRODHIMTARINË BUJQËSORE DHE KONTROLL TË KUALITETIT.....	45
3.9 Përkrahje plotësuese financiare për standardet e implementuara të sigurisë në prodhimtarinë primare	45

3.10 Kompensim të një pjese të shpenzimeve për analiza laboratorike dhe certifikim, gjatë zbatimit të standardeve të sigurisë në prodhimtarinë primare	46
--	----

DH. PRODHIMTARI BUJQËSORE ORGANIKE 48

I. PRODHIMTARI PRIMARE E CERTIFIKUAR OSE PRODHIMTARI KALIMTARE.....	48
4.1 Përkrahje plotësuese financiare prej 30% për nënpikat e pikave 1 dhe 2, të certifikuara si prodhimtari organike bimore dhe blegtorale dhe prodhimtari kalimtare , përveç për nënpikat e pikave 1 dhe 2 që kanë të bëjnë me përkrahjen e përfshirë me nënpikat 4.2 dhe 4.3	48
4.2 Përkrahje financiare për përcaktimin e hapësirave për plehërim të gjelbërt ose ugar në bimë fytdhënëse.....	49
4.3 Përkrahje financiare plotësuese për blegtori	50
II. PUNIM, PËRPUNIM DHE SHITJE TË PRODHIMEVE ORGANIKE ME PREJARDHJE VENDORE	51
4.4 Përkrahje financiare për pvpunimin e prodhimeve organike dhe prodhime organike në kalim prej prejardhjes vendore (të përfshirë për punim dhe paketim të llojeve të vetmbinura me prejardhje organike).....	51
4.5 Përkrahje financiare për shitje të prodhimeve organike dhe prodhimeve organike në kalim prej prejardhjes vendore.....	51
III. MASA TË VEÇANTA.....	52
4.6 Përkrahje financiare për kontroll profesional dhe certifikim	52
4.7 Përkrahje financiare për analizë laboratorike të ujit dhe tokës, prodhimeve organike te feramat organike.....	53

E. MASA TË PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË 54

5.1 Kompensim të harxhimeve për regjistrimin në vitin 2010 të bujqëve individual, bujq të siguruar në fondin për sigurim pensional invalidor të Republikës së Maqedonisë dhe shoqatave tregtare me veprimtari të rëndësishme primare prodhimtari bujqësore	54
5.2 Kompensim për sigurimin e prodhimeve primare bimore bujqësore prej reziqeve themelore	54

LISTA E TABELAVE

TABELA 1. KALENDARI PËR PARASHTRIMIN E KËRKESAVE PËR PRODHIMIN E BIMËVE	5
TABELA 2. KALENDARI PËR PARASHTRIMIN E KËRKESAVE PËR PRODHIMIN BLEGTORAL	6
TABELA 3. KALENDARI PËR PARASHTRIM TË KËRKESAVE PËR IMPLEMENTIM TË STANDARDEVE PËR SIGURI NË PRODHIMTARINË BUJQËSORE DHE PËR KONTROLL TË KUALITETIT	7
TABELA 4. KALENDARI PËR PARASHTRIM TË KËRKESAVE PËR PRODHIMTARI ORGANIKE	8
TABELA 5. KALENDARI PËR PARASHTRIM TË KËRKESAVE PËR MASA TË PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIM TË BUJQËSISË	9
TABELA 6. SASITË MESATARE TË FARËS PËR HEKTARË.....	13
TABELA 7. NUMRI I PEMËVE TË MBJELLA PËR HEKTAR SIPAS LLOJET E PEMËVE	17
TABELA 8. NUMRI I HARDHIVE PËR HEKTAR, NË VARËSI TË DISTANCËS MIDIS RRESHTAVE DHE DISTANCËS MIDIS HARDHIVE QË NDODHEN NË TË NJËJTIN RRESHT	19

A. HYRJE

I. Kushte të përgjithshme

Përdorues të Programit për përkrahje financiare të bujqësisë për vitin 2010 janë ekonomitë bujqësore familjare dhe personat juridik, të cilët i plotësojnë kushtet e përgjithshme në vijim:

- Të jenë të regjistruar në Regjistrin unik të ekonomive bujqësore, i cili mbahet në njësitë rajonale të Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave (në tekstin në vijim: Ministria),
- Të kenë parashtruar kërkesë për përdorim të mjeteve në afatin e paraparë për aplikim,
- T'i kenë shlyer detyrimet dhe kompensimet që dalin nga kontratat për përdorim të tokës bujqësore shtetërore, më së voni deri në ditën e parashtrimit të kërkesës,
- Deri në ditën e parashtrimit të kërkesës t'i kenë shlyer detyrimet dhe kompensimet për mekanizimin e fituar nga ndihma japoneze dhe projektet që dalin prej saj, në bazë të programit për rritje të prodhimit të ushqimit në Republikën e Maqedonisë.
- T'i kenë shlyer detyrimet dhe kompensimet që dalin nga Direktiva për mbrojtje shëndetësore të kafshëve dhe nga Ligji për identifikim dhe regjistrim të kafshëve.

II. Procedura

Për ta realizuar të drejtën e përdorimit të mjeteve të Programit për përkrahje financiare të bujqësisë për vitin 2010, hapin e parë që duhet ta bëni është plotësimi i Formularit KËRKESË.

1. Ku mund ta merrni formularin "Kërkesë"?

Formularin mund ta merrni në:

- Agjencinë për përkrahje financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural (në tekstin në vijim: Agjencia),
- Në faqen e Internetit të Agjencisë: www.ipardpa.gov.mk,
- Në njësitë rajonale të Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave,
- Në Agjencinë për përkrahje të zhvillimit të bujqësisë.

2. Ndhmë gjatë plotësimit të formularit

Ndhmë gjatë plotësimit të formularit mund të fitoni nga këshilltarët e qendrave rajonale të Agjencisë për përkrahje të zhvillimit të bujqësisë.

Formulari duhet të plotësohet me shkronja të mëdha, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme.

Nëse kërkesa nuk është plotësuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, nuk mund të vazhdoni me procesin e mëtejshëm të përpunimit.

**Formulari dhe ndihma për plotësimin e tij, e dhënë nga këshilltarët e
APZHB, JANË FALAS**

3. Dorëzimi i formularit të plotësuar

Formulari i plotësuar në dy Fotokopje, bashkë me dokumentet e nevojshme, dorëzohet në njësinë rajonale të Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, në të cilën gjendet ekonomia Juaj bujqësore.

KUJDES!!!

Kërkesë mund të parashtrinë vetëm personat që kanë ekonomi bujqësore.

Nëse prona është në pronësi të ndonjë anëtarit të ekonomisë, duhet të plotësohet Deklaratë nga udhëheqësi dhe anëtarët e ekonomisë bujqësore familjare, e cila duhet vërtetuar në noter.

Nëse ekonomia bujqësore është regjistruar në një njësi rajonale, ndërsa kërkesa parashtrëhet në një njësi tjetër, atëherë duhet parashtruar vërtetim për regjistrim në Regjistrin unik të ekonomive bujqësore, i cili jepet nga njësi rajonale ku mbahet regjistri.

Për prodhimtarinë bimore kërkesa parashtrëhet pas përfundimit të mbjelljeve. Nuk paraqiten sipërfaqet që planifikohen të mbillen por vetëm sipërfaqet e mbjella.

4. Afati për parashtrim të kërkesës

Afatet për parashtrim të kërkesës për masat e veçanta të Programit për përkrahje financiare të bujqësisë për vitin 2010 janë paraqitur në tabelat në vijim:

Tabela 1. Kalendar për parashtrimin e kërkesave për prodhimin e bimëve

Nënpika	Emri i masës	Afati për parashtrim të kërkesës
1.1	Përkrahja financiare sipas tokës bujqësore të punëshme për kulturat bujqësore	Nga 24 mars deri në 31 maj, viti 2010
1.2	Përkrahje financiare plotësuese për sipërfaqet e mbjella me drithëra, sipas pikës 1.1, me fara të certifikuar.	Nga 24 mars deri në 31 maj, viti 2010
1.3	Përkrahje financiare sipas sipërfaqes bujqësore të mbjella me perime	Nga 24 mars deri në 31 maj, viti 2010
1.4	Përkrahje financiare plotësuese për prodhimtari me kushte të kontrolluara (domate, piperka, trungje, lule të krasitura), sipas nënpikës 1.3. për vitin 2010	Nga 24 mars deri në 31 maj, viti 2010
1.5	Përkrahje plotësuese për kultura të kopshtarisë, që jepen në kapacitetet përpunuese, sipas nënpikës 1.3. për vitin 2010	Nga 1 tetor deri në 5 nëntor, viti 2010
1.6	Përkrahje financiare sipas sipërfaqes, për mirëmbajtje të vreshtave ekzistuese, të evidentuara në regjistrin e vreshtarisë deri në 30.11.2010	Nga 24 mars deri në 31 maj, viti 2010
1.7	Përkrahje financiare sipas sipërfaqes, për mirëmbajtje të pemishteve ekzistuese	Nga 24 mars deri në 31 maj, viti 2010
1.8	Përkrahje financiare për vreshta të reja, të evidentuara në regjistrin e vreshtarisë deri më 30.11.2010	Nga 24 mars deri në 31 maj, viti 2010
1.9	Përkrahje financiare për pemishte të reja	Nga 24 mars deri në 31 maj, viti 2010
1.10	Përkrahje financiare për duhanin oriental dhe me aromë dhe për duhanin gjysmëoriental, të fituar nga rendimenti i vitit 2009	Sipas listës së dorëzuar nga ndërmarrjet blerëse
1.11	Përkrahje financiare për prodhim të farave shtëpiake të certifikuar për drithëra, kultura industriale dhe të kopshtarisë (përveç duhanit)	Nga 1 tetor deri në 5 nëntor, viti 2010

1.12	Përkrahje financiare për prodhim të kalemave shtëpiak për vreshta dhe për pemishte	Nga 1 tetor deri në 5 nëntor, viti 2010
1.13	Përkrahje financiare për prodhim dhe përpunim të farës shtëpiake të certifikuar të duhanit	Nga 1 tetor deri në 5 nëntor, viti 2010
1.14	Përkrahje financiare për analiza agrokimike ose pedologjike të tokës në vitin 2010	Nga 24 mars deri në 30 gusht të vitit 2010
1.15	Përkrahje financiare sipas sipërfaqeve të mbjella me mollë	Nga 1 mars deri në 26 mars të vitit 2010

Tabela 2. Kalendarri për parashtrimin e kërkesave për prodhimin blegtoral

Nënpika	Emri i masës	Afati për parashtrim të kërkesës
2.1	Përkrahje financiare për bagëtitë e evidentuara	Nga 24 mars deri në 31 maj, viti 2010
2.2	Përkrahje financiare për qumështin e prodhuar dhe të shitur të lopëve	1. Nga 15 shkurt deri në 15 mars për qumështin e shitur nga 1 tetor deri në 31 dhjetor të vitit 2009 2. Nga 15 maj deri në 15 qershor për qumështin e shitur nga 1 janar deri në 31 prill të vitit 2009 3. Nga 5 tetor deri në 5 nëntor për qumështin e shitur nga 1 maj deri në 30 shtator të vitit 2009
2.3	Përkrahje financiare për bagëtitë e ruajtura dhe të therura në ndonjë kapacitet therës të regjistruar	Nga 1 tetor deri në 5 nëntor, viti 2010
2.4	Përkrahje financiare për çdo viç të fituar me pllenim artificial	Nga 1 tetor deri në 5 nëntor, viti 2010
2.5	Përkrahje financiare për blerje të mëshqerrave pjellore, me prejardhje të njohur dhe me potencial të madh gjenetik.	Nga 1 tetor deri në 5 nëntor, viti 2010
2.6	Përkrahje financiare për delet e evidentuara të të gjitha kategorive	Nga 24 mars deri në 31 maj, viti 2010
2.7	Përkrahje financiare për blerje të demave pjellor-original dhe për shumim	Nga 1 tetor deri në 5 nëntor, viti 2010
2.8	Përkrahje financiare për dhitë e evidentuara	Nga 24 mars deri në 31 maj, viti 2010
2.9	Përkrahje financiare për blerje të demave pjellor	Nga 1 tetor deri në 5 nëntor, viti 2010
2.10	Përkrahje financiare sipas numrit të dosave	Nga 24 mars deri në 31 maj, viti 2010
2.11	Përkrahje financiare për derrat e ruajtura dhe të therura në ndonjë nga kapacitet therëse	Nga 1 tetor deri në 5 nëntor, viti 2010
2.12	Përkrahje financiare për blerje të dosave pjellore	Nga 1 tetor deri në 5 nëntor, viti 2010

2.13	Përkrahje financiare për zogjtë e ruajtur dhe të therur në ndonjë nga kapacitet therëse të regjistruara	Nga 1 tetor deri në 5 nëntor, viti 2010
2.14	Përkrahje financiare për pulat pjellëse të therura në ndonjë nga kapacitet therëse të regjistruara	Nga 1 tetor deri në 5 nëntor, viti 2010
2.15	Përkrahje financiare për prodhim të zogjve njëditor	Nga 1 tetor deri në 5 nëntor, viti 2010
2.16	Përkrahje financiare për prodhim të zogjve femra njëditor nga hibridë që japin vezë	Nga 1 tetor deri në 5 nëntor, viti 2010
2.17	Përkrahje financiare sipas familjeve të regjistruara të bletëve që e kanë kaluar dimrin	Nga 24 mars deri në 31 maj, viti 2010
2.18	Përkrahje financiare për blerje të mbretëreshave të bletëve	Nga 1 tetor deri në 5 nëntor, viti 2010
2.19	Përkrahje financiare për hapje të sipërfaqeve të reja në vende ku mund të grumbullohet mjalti (vende me barëra që japin shumë mjaltë, rogoveckë)	Nga 24 mars deri në 31 maj, viti 2010
2.20	Përkrahje financiare për ruajtjen e strucëve në ferma	Nga 24 mars deri në 31 maj, viti 2010
2.21	Përkrahje financiare për rritjen e kërmijve në ferma	Nga 24 mars deri në 31 maj, viti 2010

Tabela 3. Kalendar për parashtrim të kërkesave për implementim të standardeve për siguri në prodhimtarinë bujqësore dhe për kontroll të kualitetit

Nënpika	Emri i masës	Afati për parashtrim të kërkesës
3.1	Përkrahje financiare për kompensimin e shpenzimeve për prodhim sipas prodhimeve të mbrojtura bimore dhe shtazore	Nga 24 mars deri në 1 dhjetor të vitit 2010
3.2	Përkrahje financiare për përdoruesit e emrit të mbrojtur gjeografik	Nga 24 mars deri në 1 dhjetor të vitit 2010
3.3	Përkrahje plotësuese financiare për prodhim të lëndës së parë për prodhime bujqësore ushqimore me emër të mbrojtur gjeografik	Nga 24 mars deri në 1 dhjetor të vitit 2010
3.4	Përkrahje financiare për përgatitje të elaboratit për mbrojtje të emrit gjeografik të prodhimeve dhe përpunimeve të caktuara bujqësore	Nga 24 mars deri në 1 dhjetor të vitit 2010
3.5	Përkrahje financiare për kontroll dhe certifikim të emrit të mbrojtur gjeografik të prodhimeve dhe përpunimeve të caktuara gjeografike	Nga 24 mars deri në 1 dhjetor të vitit 2010
3.6	Përkrahje financiare për regjistrim në regjistrin ndërkombëtar për mbrojtje të emrit gjeografik	Nga 24 mars deri në 1 dhjetor të vitit 2010

3.7	Përkrahje financiare për realizim të fushatës për promovim të prodhimeve bujqësore-ushqimore maqedonase, duke e mbrojtur emrin e tyre gjeografik në tregun vendas dhe të huaj	Nga 24 mars deri në 1 dhjetor të vitit 2010
3.8	Përkrahje financiare për etiketim dhe shënim të prodhimeve me emër të mbrojtur gjeografik dhe të specialiteteve tradicionale	Nga 24 mars deri në 1 dhjetor të vitit 2010
3.9	Përkrahje plotësuese financiare për standardet e implementuara të sigurisë në prodhimtarinë primare	Nga 24 mars deri në 1 dhjetor të vitit 2010
3.10	Kompensim të një pjese të shpenzimeve për analiza laboratorike dhe certifikim, gjatë zbatimit të standardeve të sigurisë në prodhimtarinë primare	Nga 24 mars deri në 1 dhjetor të vitit 2010

Tabela 4. Kalendar për parashtrim të kërkesave për prodhimtari organike

Nënpika	Emri i masës	Afati për parashtrim të kërkesës
4.1	Përkrahje plotësuese financiare prej 30% për nënpikat e pikave 1 dhe 2, të certifikuar si prodhimtari organike bimore dhe blegtorale dhe prodhimtari kalimtare, përveç për nënpikat e pikave 1 dhe 2 që kanë të bëjnë me përkrahjen dhe që janë përfshirë me nënpikat 4.2 dhe 4.3	Paraqitja deri në 31 maj, ndërsa kërkesat për pagim deri në 1 dhjetor të vitit 2010
4.2	Përkrahje financiare për sipërfaqet e dedikuara për plehra të gjelbra/ugar në pjesët pjellore	Paraqitja deri në 31 maj, ndërsa kërkesat për pagim deri në 1 dhjetor të vitit 2010
4.3	Përkrahje plotësuese financiare për blegtorinë organike	Paraqitja deri në 31 maj, ndërsa kërkesat për pagim deri në 1 dhjetor të vitit 2010
4.4	Përkrahje financiare për përpunim të prodhimeve organike dhe prodhimeve organike kalimtare vendase (duke e përfshirë edhe përkrahjen për përpunim dhe paketim të llojeve organike që kanë dalë vet)	Paraqitja deri në 31 maj, ndërsa kërkesat për pagim deri në 1 dhjetor të vitit 2010
4.5	Përkrahje financiare për shitje të prodhimeve organike dhe prodhimeve organike kalimtare vendase	Paraqitja deri në 31 maj, ndërsa kërkesat për pagim deri në 1 dhjetor të vitit 2010
4.6	Përkrahje financiare për kontroll dhe certifikim profesional	Paraqitja deri në 31 maj, ndërsa kërkesat për pagim deri në 1 dhjetor të vitit 2010
4.7	Përkrahje financiare për analiza laboratorike të tokës dhe ujit dhe analiza të prodhimeve organike	Paraqitja deri në 31 maj, ndërsa kërkesat për pagim deri në 1 dhjetor të vitit 2010

Tabela 5. Kalendarri për parashtrim të kërkesave për masa të përgjithshme për zhvillim të bujqësisë

Nënpika	Emri i masës	Afati për parashtrim të kërkesës
5.1	Kompensim të shpenzimeve për regjistrim në vitin 2010 të bujqve individual, bujqve të siguruar në Fondin për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë dhe shoqatave tregtare, veprimtaria kryesore e të cilave është prodhimtaria bujqësore primare	Nga 24 mars deri në 1 dhjetor të vitit 2010
5.2	Kompensim për sigurimin e prodhimtarisë bujqësore primare në vitin 2010	Nga 24 mars deri në 31 gusht të vitit 2010

III. Pagimi i mjeteve financiare

Pagimin e mjeteve sipas përdoruesve e realizon Agjencia.

Pagimi i mjeteve realizohet në llogaritë transaksione të kërkuësve, pas përfundimit të kontrolleve administrative dhe kontrolleve në terren.

IV. Përlllogaritja e përkrahjes financiare

Për një sipërfaqe prodhuese kërkuesi mund të parashtroj kërkesë vetëm për një kulturë. Nëse gjatë kontrolleve administrative dhe kontrolleve në terren do të konstatohet e kundërta, atëherë nuk realizohet pagimi i mjeteve për atë qëllim.

Nëse gjatë kontrolleve në terren konstatohet se madhësia e kapaciteteve është:

- *Më e madhe nga madhësia e kapaciteteve të shënuara në kërkesë*, shuma e përkrahjes financiare do të përlllogaritet sipas kapaciteteve të paraqitura,

- *Më e vogël deri në 5% nga madhësia e kapaciteteve të shënuara në kërkesë*, shuma e përkrahjes financiare do të përlllogaritet sipas kapaciteteve të konstatuara gjatë kontrollit në terren, e zvogëluar për shumën e diferencës së konstatuar,

- ***Më e vogël, midis 5%-20% ose për 2 ha, nga madhësia e sipërfaqes së shënuar në kërkesë***, shuma e përkrahjes financiare do të përlllogaritet sipas kapaciteteve të konstatuara gjatë kontrollit, e zvogëluar për shumën e dallimit të konstatuar dhe e rritur dy herë,

- ***Më e vogël më shumë se 20% nga madhësia e kapaciteteve të shënuara në kërkesë***, kërkuesi tërësisht përjashtohet nga e drejta për përdorim të mjeteve të programit.

Nëse kapacitete prodhuese gjenden në rajone me kushte të vështira për prodhim, kriteret minimale për përkrahje financiare, të vërtetuara në program, zvogëlohen për 50% dhe paguhet shuma e plotë e përkrahjes financiare, pa e reduktuar shumën e përkrahjes lidhur me sipërfaqen e paraqitur dhe me numrin e bagëtive.

V. Përkrahje financiare plotësuese

Përkrahje financiare plotësuese mund të fitojnë ekonomitë bujqësore familjare, të cilat i plotësojnë kushtet në vijim:

1. Ekonomitë bujqësore familjare që gjenden në rajone me kushte të vështira për prodhim, të cilat mund ta realizojnë të drejtën e përdorimit të përkrahjes plotësuese prej 15% të shumës së përcaktuar.
2. Për kapacitetet prodhuese në pronësi të udhëheqësit të ekonomisë bujqësore familjare deri në moshën 40-vjeçare ose të udhëheqësve të gjinisë femërore, mund të realizohet e drejta e përdorimit të përkrahjes plotësuese prej 10% të shumës së përcaktuar.

3. Përdoruesit e regjistruar në regjistrin për ushtrim të veprimtarive bujqësore, në përputhje me Ligjin për ushtrim të veprimtarisë bujqësore ose bujqit e siguruar në përputhje me Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor, të cilët deri në ditën e parashtrimit të kërkesës nuk kanë detyrime lidhur me kontributet për sigurim pensional, invalidor dhe shëndetësor, mund ta realizojnë të drejtën e përdorimit të përkrahjes plotësuese prej 5% nga shuma e përcaktuar. Për realizimin e të drejtës së përkrahjes plotësuese, përveç dokumenteve bazë, duhet parashtruar edhe dëshmi për kontribute të paguara për sigurim pensional dhe invalidor, e cila lëshohet nga FSPIM si dhe dëshmi për kontribute të paguara për sigurim shëndetësor, e cila lëshohet nga FSSHM.

ME RËNDËSI për personat që ruajnë bagëti të trasha, dele dhe dhi!!!

Kontrollimi i saktësisë së të dhënave të shënuara në kërkesë do të bëhet duke i krahasuar të njëjtat me të dhënat e regjistrave zyrtare të kafshëve, të cilët mbahen në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave – Drejtoria veterinare.

Detyrimi juaj është që çdo ndryshim në numrin e bagëtive ta paraqisni në stacionet veterinare. Para dorëzimit të kërkesës kontrollojeni numrin e bagëtive tuaja të evidentuara në stacionet veterinare, e cila është përgjegjëse për evidentimin e tyre.

Paraqitini vetëm bagëtitë që planifikoni t'i mbani deri në fund të afatit të paraparë për ruajtje të bagëtive.

Mos i paraqitni bagëtitë për rinovim të tufës ose bagëtitë që planifikoni t'i shisni për arsye të ndryshme.

Nëse numri i bagëtive do të zvogëlohet si rezultat të fatkeqësive natyrore, jeni të detyruar që zvogëlimin e numrit të bagëtive ta paraqisni me shkrim në Agjenci, brenda 7 ditëve nga dita e ndryshimit dhe njëkohësisht të parashtroni dëshmi relevante.

B. PRODHIMTARIA BIMORE

Për përdorim të mjeteve për prodhimtari bimore, përveç dokumenteve të tjera, duhet parashtruar dëshmi me të cilën do të vërtetohet pronësia e tokës bujqësore ose mënyra e përdorimit të saj.

Si dëshmi për tokën bujqësore parashtrohet një nga dokumentet në vijim:

1. Fletë pronësie, jo më e vjetër se 6 muaj,
2. Fletë posedimi, jo më e vjetër se 6 muaj,
3. Fotokopje e Kontratës për marrje me qira të tokës bujqësore shtetërore, me Proçesverbal për marrje të tokës në përdorim,
4. Kontratë për marrje me qira të tokës bujqësore private, të vërtetuar në noter. Përveç Kontratës duhet dorëzuar edhe një nga dokumentet e shënuara nën pikat 1 ose 2, të cilat duhet të jenë në emër të qiradhënësit,
5. Kontratë për përdorimin e tokës së mbjellë bujqësore që është në pronësi të shtetit, me Proçesverbal për marrjen në përdorim të tokës,
6. Kontratë për përdorimin e tokës së mbjellë bujqësore që është në pronësi private, e vërtetuar në noter. Përveç Kontratës duhet dorëzuar edhe një nga dokumentet e shënuara nën pikat 1 ose 2, të cilat duhet të jenë në emër të pronarit të tokës së mbjellë bujqësore.

I. Bujqësia

1.1 Përkrahje financiare sipas sipërfaqeve që punohen me kultura bujqësore

Përdorues

Përdorues të kësaj mase mund të jenë ekonomitë bujqësore familjare dhe personat juridik, të cilët gjatë vitit 2009/2010 sipërfaqet bujqësore i kanë mbjellë me kulturat në vijim: grurë, elb, misër, thekër, tërshërë, oriz, thjerrëz, kikirik, sojë, luledielli, rrepë vaji, afion, panxhar sheqeri, jonxhe, groshëz, esparzeta, bizele për bagëti, leblebi etj.

Kushte për përdorim të mjeteve financiare

Minimum 0,3 ha të mbjella me drithëra, gjatë vitit 2009/2010.

Minimum i sipërfaqeve të mbjella vlen për secilën kulturë bujqësore në veçanti.

Përkrahje financiare

Shuma e përkrahjes financiare arrin në 8.000,00 denarë për ha, për çdo kulturë në veçanti, duke e reduktuar shumën e përkrahjes me rritjen e sipërfaqeve të paraqitura:

1.	nga 0,3 deri në 20 ha	100%
2.	nga 20,1 deri në 100 ha	60%
3.	nga 100,1 deri në 300 ha	30%
4.	mbi 300 ha	10%

Shembull:

Nëse keni mbjellë 325 ha grurë dhe 85 ha elb, përlllogaritja e shumës së përkrahjes financiare që do ta fitoni do të bëhet në mënyrën në vijim:

Grurë: 325 ha	
20 ha	8.000 den. = 160.000 den.
80 ha	4.800 den. = 384.000 den.
200 ha	2.400 den. = 480.000 den.
25 ha	800 den. = 20.000 den.

Sipas përlllogaritjes, për grurin do të fitoni 1.044.000,00 denarë.

Elb: 85 ha	
20 ha	8.000 den. = 160.000 den.
65 ha	4.800 den. = 312.000 den.

Sipas përlllogaritjes, për elbin do të fitoni 472.000,00 denarë.

Dokumentet e nevojshme

Ekonomi bujqësore familjare:

- Kërkesë
- FotoFotokopje e letërnjoftimit
- FotoFotokopje e llogarisë transaksione
- Dëshmi për pronësinë ose marrjen me qira të tokës bujqësore
- Kontratë për kultivimin e afionit

Personat juridik:

- Kërkesë
- Gjendja aktuale e personit juridik, e lëshuar nga Regjistri qendror, jo më e vjetër se 6 muaj
- FotoFotokopje e llogarisë transaksione
- Dëshmi për pronësinë ose marrjen me qira të tokës bujqësore
- Kontratë për kultivimin e afionit

1.2 Përkrahje financiare plotësuese për sipërfaqe të mbjella me drithëra nga nënpika 1.1. me farë të certifikuar

Përdorues

Përdorues të kësaj mase mund të jenë ekonomitë bujqësore familjare dhe personat juridik, të cilët gjatë vitit 2009/2010 kanë mbjellë sipërfaqe me drithëra sipas nënpikës 1.1, me farë të certifikuar.

Kushte për përdorim të mjeteve financiare

Minimum 0,3 ha sipërfaqe të mbjella me drithëra, gjatë vitit 2009/2010.

Minimum i sipërfaqeve të mbjella vlen për secilën kulturë bujqësore në veçanti.

Sasitë e pranueshme të farave për mbjellje mesatare për hektar janë si në vijim:

Tabela 6. Sasitë mesatare të farës për hektarë

Lloji	Masa e 1000 kokrrave	Norma për mbjellje		Mesatarisht kg/ha
		Numri i kokrrave për m ²	Kg/ha	
Grurë	40-45	600-700	250-300	270
Elb	35-40	450-500	160-200	180
Tritikale	45-55	450-550	240-300	250
Thekër	40-50	450-500	180-250	200
Tërshërë	30-35	400-450	120-160	140
Oriz	37-44	450-500	170-220	200
Misër	300-500	6,5-8,0	20-40	30
Sirak	20-30	6,0-12,0	10-30	20

Përkrahja financiare

Shuma e përkrahjes financiare arrin në 2.500,00 denarë për ha, për çdo kulturë në veçanti, duke e reduktuar shumën e përkrahjes me rritjen e sipërfaqeve të paraqitura:

1.	nga 0,3 deri në 20 ha	100%
2.	nga 20,1 deri në 100 ha	60%
3.	nga 100,1 deri në 300 ha	30%
4.	mbi 300 ha	10%

Dokumentet e nevojshme

Krahas dokumenteve të përmendura në nën pikën 1.1, duhen dorëzuar edhe dokumentet në vijim:

- Llogari fiskale me dokument shoqërues për identifikim të personit që i përket llogaria fiskale (mandat arkëtimi, fletëdërgesë, faturë e paguar me kesh) ose faturë me fletëdërgesë për blerjen e farës, duke e përfshirë edhe dëshminë për pagimin sipas faturave (ekstrakt bankar nga pagimi i rregullt, kompensim me ekstrakt bankar nga kompensimi i mëparshëm).

Sasia e farës duhet shprehur në kilogram.

Në rastet kur fara prodhohet nga vet përdoruesi, duhen parashtruar edhe:

- Certifikatë e lëshuar nga institucioni kompetent dhe
- Fletëdërgesë në të cilën duhet shënuar sasia e farës së shprehur në kilogram

II. Kopshtaria

1.3 Përkrahje financiare plotësuese për sipërfaqe të mbjella me kultura të kopshtarisë

Përdorues

Përdorues të kësaj mase mund të jenë ekonomitë bujqësore familjare dhe personat juridik, të cilët sipërfaqet e tyre i kanë mbjellë kulturat në vijim: domate, piperka, shalqinj, pjepër, fasule, bishtaje, bizele, patate, trungje, kërpudha, lakër, qep, hudhër, presh, kungulleshka, kunguj, sallatë e gjelbër, brokoli, spinaq, lule lakër, karota, selino, rrepë e kuqe, asparagus, repëza, lule dhe bimë aromatike dhe erëza. Lista e bimëve aromatike, mjekësore dhe erëzave që janë objekt të përkrahjes financiare të kësaj mase është dhënë në Shtojcën 1.

Kushte për përdorim të mjeteve financiare

Minimum 0,2 ha sipërfaqe të mbjella me kultura të kopshtarisë.

Minimum i sipërfaqeve të mbjella vlen për të gjitha kulturat.

Përkrahja financiare

Për sipërfaqet e mbjella sipas kësaj mase, shuma e përkrahjes financiare arrin në 20.000,00 denarë për ha.

Dokumentet e nevojshme

Ekonomi bujqësore familjare:

- Kërkesë
- FotoFotokopje e letërnjoftimit
- FotoFotokopje e llogarisë transaksione
- Dëshmi për pronësinë ose marrjen me qira të tokës bujqësore

Personat juridik:

- Kërkesë
- Gjendja aktuale e personit juridik, e lëshuar nga Regjistri qendror, jo më e vjetër se 6 muaj
- FotoFotokopje e llogarisë transaksione
- Dëshmi për pronësinë ose marrjen me qira të tokës bujqësore

1.4 Përkrahje financiare plotësuese për prodhimtari nën kushte të kontrolluara (domate, piperka, trungje dhe lule të krasitura) nga nënpika 1.3, në vitin 2010

Përdorues

Përdorues të kësaj mase mund të jenë ekonomitë bujqësore familjare dhe personat juridik, të cilët prodhojnë domate, piperka, trungje dhe lule të krasitura në hapësira të mbyllura dhe nën kushte të kontrolluara dhe të cilët kanë parashtruar kërkesë në vitin 2010 për nënpikën 1.3.

Kushte për përdorim të mjeteve financiare

Minimum 0,2 ha sipërfaqe të mbjella në sera, prodhimtari e realizuar për vitin 2010 dhe e njëjta të jetë shitur në tregun vendas ose të jetë eksportuar më së voni deri në 15.05.2010.

Përkrahja financiare

Për sipërfaqet e mbjella sipas kësaj mase, shuma e përkrahjes financiare arrin në 80.000,00 denarë për hektarë.

Dokumentet e nevojshme

Ekonomi bujqësore familjare:

- Kërkesë
- FotoFotokopje e letërnjoftimit
- FotoFotokopje e llogarisë transaksione
- Dëshmi për pronësinë ose marrjen me qira të tokës bujqësore (serrës) ose dëshmi për të drejtën e përdorimit të oranzherisë
- Shënim për prodhimin e shitur në tregun vendas deri në 15.05.2010.

Personat juridik:

- Kërkesë
- Gjendja aktuale e personit juridik, e lëshuar nga Regjistri qendror, jo më e vjetër se 6 muaj
- FotoFotokopje e llogarisë transaksione
- Dëshmi për pronësinë ose marrjen me qira të tokës bujqësore (serrës) ose dëshmi për të drejtën e përdorimit të oranzherisë
- Faturë me fletëpranim të vërtetuara nga person i autorizuar për prodhimet e shitura në tregun vendas deri në 15.05.2010 ose deklaratë doganore për eksportin e realizuar deri në 15.05.2010.

1.5 Përkrahje plotësuese financiare për prodhimet e kopshtarisë që në vitin 2010 janë dhënë në ndonjë nga kapacitetet përpunuese sipas nënpikës 1.3

Përdorues

Përdorues të kësaj mase mund të jenë ekonomitë bujqësore familjare dhe personat juridik, të cilët kanë mbjellë sipërfaqe me prodhime të kopshtarisë dhe kanë parashtruar kërkesë në vitin 2010 për nënpikën 1.3.

Kushte për përdorim të mjeteve financiare

Minimum 0,2 ha sipërfaqe të mbjella me prodhime të kopshtarisë sipas nënpikës 1.3 në vitin 2010 dhe të njëjtat të jenë shitur në industrinë e përpunimit të perimeve, më së voni deri në 31.10.2010.

Përkrahja financiare

Për sipërfaqet e mbjella dhe për prodhimtarinë e realizuar sipas kësaj mase, shuma e përkrahjes financiare arrin në 1,5 denarë për kilogram.

Dokumentet e nevojshme

Ekonomi bujqësore familjare:

- Kërkesë
- FotoFotokopje e letërnjoftimit
- FotoFotokopje e llogarisë transaksione
- Dëshmi për pronësinë ose marrjen me qira të tokës bujqësore
- Kontratë me industrinë e përpunimit të perimeve
- Dokument për blerjen e realizuar, e vërtetuar nga person i autorizuar, për sasi të shitura në industrinë e përpunimit të perimeve deri në 31.10.2010.

Personat juridik:

- Kërkesë
- Gjendja aktuale e personit juridik, e lëshuar nga Regjistri qendror, jo më e vjetër se 6 muaj
- FotoFotokopje e llogarisë transaksione
- Dëshmi për pronësinë ose marrjen me qira të tokës bujqësore
- Kontratë me industrinë e përpunimit të perimeve
- Faturë me fletëpranim, të vërtetuara nga person i autorizuar, për sasi të shitura në industrinë e përpunimit të perimeve deri në 31.10.2010.

III. Vreshtari dhe Pemëtari

Kusht për përdorim të mjeteve financiare nga masat për vreshtarinë është që sipërfaqet e mbjella me vreshta të evidentohen në Regjistrin e vreshtave, i cili mbahet në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave në njësitë rajonale në vijim: Manastir, Valandovë, Negotinë, Kavadrçë, Sveti Nikole dhe Kisela Voda. Pasqyra e komunave dhe përkatësia e tyre sipas njësive rajonale të përfshira me kadastrën e vreshtarisë është paraqitur në Shtojcën 3.

1.6. Përkrahje financiare sipas sipërfaqeve për mirëmbajtje të vreshtave ekzistuese, të evidentuara në regjistrin e vreshtave deri në 30.11.2010

Përdorues

Përdorues të kësaj mase mund të jenë ekonomitë bujqësore familjare dhe personat juridik, të cilët kanë mbjellë sipërfaqe me vreshta.

Kushte për përdorim të mjeteve financiare

Minimum 0,2 ha sipërfaqe me vreshta, të evidentuara në regjistrin e vreshtave deri më 31.11.2010. Përkrahja financiare paguhet pas vitit të dytë nga mbjellja e sipërfaqeve me vreshta.

Përkrahja financiare

Shuma e përkrahjes financiare arrin në 40.000,00 denarë për hektarë, me reduktim të shumës së përkrahjes, me rritje të sipërfaqeve të paraqitura.

1.	nga 0,2 deri në 5 ha	100%
2.	nga 5,1 deri në 30 ha	60%
3.	nga 30,1 deri në 50 ha	30%
4.	mbi 50 ha	10%

Dokumentet e nevojshme

Ekonomi bujqësore familjare:

- Kërkesë
- FotoFotokopje e letërnjoftimit
- FotoFotokopje e llogarisë transaksione
- Dëshmi për pronësinë ose marrjen me qira të tokës bujqësore
- Vërtetim për vreshtat e evidentuara në regjistrin e vreshtave, i cili lëshohet nga njësia rajonale e ministrisë.

Personat juridik:

- Kërkesë
- Gjendja aktuale e personit juridik, e lëshuar nga Regjistri qendror, jo më e vjetër se 6 muaj
- FotoFotokopje e llogarisë transaksione
- Dëshmi për pronësinë ose marrjen me qira të tokës bujqësore
- Vërtetim për vreshtat e evidentuara në regjistrin e vreshtave, i cili lëshohet nga njësia rajonale e ministrisë.

1.7. Përkrahje financiare sipas sipërfaqes për mirëmbajtje të pemishteve ekzistuese (përveç për sipërfaqet e paraqitura që janë mbjellë me mollë sipas nënpikës 1.15)

Përdorues

Përdorues të kësaj mase mund të jenë ekonomitë bujqësore familjare dhe personat juridik, të cilët kanë mbjellë sipërfaqe me pemë të këtyre llojeve: molla, dardha, ftonj, mushmolle, kumbulla, pjeshka, kajsi, qersh, vishnja, ara, bajame, lajthi, gështenja me maja të mprehta, aktinidi, rrush serezi/stafidhe, mjedra, manaferra, lule trëndafili, luleshtrydhe, ullinj, shega, hurma, aroni dhe fiq.

Kushte për përdorim të mjeteve financiare

Minimum 0,3 ha sipërfaqe me pemishte.

Përkrahja financiare paguhet pas vitit të dytë nga mbjellja e sipërfaqeve me pemë.

Nuk parashtrahet kërkesë për këtë masë, për sipërfaqet me mollë të cilët janë paraqitur sipas 1.15.

Numri i pranueshëm i sipërfaqeve të mbjella për hektar duhet të jetë:

Tabela 7. Numri i pemëve të mbjella për hektar sipas llojet e pemëve

Lloji i pemës	Dendësia e bazamentit	Sistemi i kultivimit	Distanca midis pemëve (në metro)	Numri i pemëve për hektar
Mollë	E dendur dhe mesatare	E lirë	6-8 x 5-7	178-333
	Mesatare	Mbjellje gjysmë të dendura	4-5 x 2.5-4	500-1000
	Pak të dendura		3.5-4 x 1.5-2.5	1000-1905
Dardhë	Të dendura	E lirë	4-6 x 3-5	333-833
	Pak të dendura	Palmetë jo e rregullt dhe mbjellje të dendura	3-4 x 1.3-2	1250-2564
Ftua	Ftua	E lirë	4-5 x 3.5-4	500-714
Mushmollë	Ftua	E lirë	4-4.5 x 3-4	555-833
Kumbull	Kumblla gjatore	E lirë	5-6 x 4-5	333-500
	Kumblla gjatore	E lirë	5-6 x 4-5	277-500
Pjeshkë	Pjeshkë e egër	Gotë	5-6 x 4-5	333-500
	Pjeshkë e egër	Palmetë	4-4.5 x 3-3.5	635-833
	Pjeshkë e egër	E dendur, e dredhur	4-4.5 x 1.7-2	470-1111
Kajsi	Kajsi dhe kumblla gjatore	Gjysmë të dendura	5-6 x 3.5-4	416-571
Qersh	Margivë	E lirë	6-7x5-6	238-332
	Margive	Kacube e lirë	5 x 3.5-4	500-571
Vishnja	Margive	Piramidale	4-5x3-4	500-833
	E madhe	Kacube e lirë	4 x 2.5-3	833-1000
Arra	Arra	Të lira	10-12x8-12	69-125
Bajame	Bajame	Gotë e lirë	5-6x4-5	333-500
Lajthi		Kacube	5x3-4	500-666
		Ne forme druri	4-5x3-3.5	571-833

Aktinidi		Pergola	4-4.5 x 3-4	555-833
Rrush serezi/ stafidhe			2.5-3 x 0.5-1	3333-8000
Mjedër			2-2.5 x 0.3-0.5	8000-16666
Manaferrë			3-4 x 1.2-2	1250-2777
Lule trëndafili			3-4x1-1.5	1666-3333
Luleshtrydhe			0.6-0.8 x 0.2-0.4	31250-83333
Ullinj			4-5x5-6	333-500
Shegë			4x3-4	625-833
Aroni			1,5x2,5	2666
Fik			3-4x4-5	500-833
Hurmë			4-5x5-6	333-500
Geshtenje			8x6	208

Përkrahja financiare

Shuma e përkrahjes financiare arrin në 18.000,00 denarë për hektarë, me reduktim të shumës së përkrahjes, me rritje të sipërfaqeve të paraqitura.

1.	nga 0,3 deri në 5 ha	100%
2.	nga 5,1 deri në 30 ha	60%
3.	nga 30,1 deri në 50 ha	30%
4.	mbi 50 ha	10%

Dokumentet e nevojshme

Ekonomi bujqësore familjare:

- Kërkesë
- FotoFotokopje e letërnjoftimit
- FotoFotokopje e llogarisë transaksione
- Dëshmi për pronësinë ose marrjen me qira të tokës bujqësore

Personat juridik:

- Kërkesë
- Gjendja aktuale e personit juridik, e lëshuar nga Regjistri qendror, jo më e vjetër se 6 muaj
- FotoFotokopje e llogarisë transaksione
- Dëshmi për pronësinë ose marrjen me qira të tokës bujqësore

1.8 Përkrahje financiare për mbjelljet e reja të vreshtave të evidentuara në regjistrin e vreshtave deri më 30.11.2010

Përdorues

Përdorues të kësaj mase mund të jenë ekonomitë bujqësore familjare dhe personat juridik, të cilët kanë mbjellë sipërfaqe të reja me vreshta në vjeshtën e vitit 2009 dhe pranverën e vitit 2010, me lloje rrushi tavoline ose të varura.

Kushte për përdorim të mjeteve financiare

Minimum 0,2 ha sipërfaqe të reja të mbjella me vreshta, të evidentuara në regjistrin e vreshtave deri më 30.11.2010.

Llojet e rrushit të varur duhet të jenë në përputhje me listën e llojeve të rrushit të aprovuara dhe të rekomanduara.

Lista e llojeve të rrushit të aprovuara dhe të rekomanduara, si dhe llojet e rrushit të tavolinës të cilët janë objekt i përkrahjes financiare janë prezantuar në Shtojcën 2.

Kusht obligues për kërkuesin e përkrahjes financiare është që i njëjti të ketë realizuar analizë agrokimike të tokës.

Përkrahja financiare

Shuma e përkrahjes financiare arrin në 140.000,00 denarë për hektarë.

Numri i pranueshëm i kalemave për mbjellje është:

Tabela 8. Numri i hardhive për hektar, në varësi të distancës midis rreshtave dhe distancës midis hardhive që ndodhen në të njëjtin rresht

Distanca midis rreshtave e shprehur në (m)	Distanca midis hardhive që ndodhen në të njëjtin rresht, e shprehur në (metra)								
	0.7	0.9	1.1.	1.2.	1.3.	1.5.	1.7.	1.9.	2.0.
1.2	11.905	9.259	7.576	6.944	6.410	5.556	4.902	4.386	4.167
1.4	10.204	7.936	6.494	5.952	5.495	4.762	4.202	3.760	3.571
1.6	8.929	6.944	5.682	5.208	4.808	4.167	3.676	3.289	3.125
1.8	7.936	6.173	5.051	4.630	4.274	3.704	3.268	2.924	2.778
2.0	7.143	5.556	4.545	4.167	3.846	3.333	2.941	2.632	2.500
2.2	6.494	5.050	4.132	3.788	3.497	3.030	2.674	2.392	2.273
2.4	5.952	4.629	3.788	3.472	3.205	2.778	2.451	2.193	2.083
2.6	5.494	2.778	3.496	3.205	2.959	2.564	2.262	2.024	1.923
2.8	5.102	3.968	3.247	2.976	2.747	2.381	2.101	1.880	1.786
3.0	4.762	3.704	3.030	2.778	2.564	2.222	1.961	1.754	1.667
3.2	4.464	3.472	2.841	2.604	2.404	2.083	1.838	1.645	1.562
3.4	4.202	3.268	2.674	2.451	2.262	1.961	1.730	1.548	1.471
3.6	3.968	3.086	2.525	2.315	2.137	1.852	1.634	1.462	1.389

Dokumentet e nevojshme**Ekonomi bujqësore familjare:**

- Kërkesë
- FotoFotokopje e letërnjoftimit
- FotoFotokopje e llogarisë transaksione
- Dëshmi për pronësinë ose marrjen me qira të tokës bujqësore
- Certifikatë për prejardhjen e materialit që përdoret për mbjellje (për materialin e mbjellë, të siguruar nëpërmjet importit)
- Fitosertifikat (për materialin e mbjellë, të siguruar nëpërmjet importit)
- Vërtetim për pastërtinë e llojit (për materialin e mbjellë që ka prejardhje vendase)
- Vërtetim për gjendjen shëndetësore (për materialin e mbjellë që ka prejardhje vendase)

- Llogari fiskale me fletëdërgesë ose faturë me fletëdërgesë për materialin e blerë për mbjellje, si dhe dëshmi për pagesën e realizuar sipas faturës
- Raport nga analiza agrokimike
- Vërtetim për vreshtat e mbjella të evidentuara në regjistrin e vreshtave, i lëshuar nga njësia rajonale e ministrisë.

Personat juridik:

- Kërkesë
- Gjendja aktuale e personit juridik, e lëshuar nga Regjistri qendror, jo më e vjetër se 6 muaj
- FotoFotokopje e llogarisë transaksione
- Dëshmi për pronësinë ose marrjen me qira të tokës bujqësore
- Certifikatë për prejardhjen e materialit që përdorej për mbjellje (për materialin e mbjellë, të siguarur nëpërmjet importit)
- Fitosertifikat (për materialin e mbjellë, të siguarur nëpërmjet importit)
- Vërtetim për pastërtinë e llojit (për materialin e mbjellë që ka prejardhje vendase)
- Vërtetim për gjendjen shëndetësore (për materialin e mbjellë që ka prejardhje vendase)
- Faturë me fletëdërgesë për materialin e blerë për mbjellje, si dhe dëshmi për pagesën e realizuar sipas faturës
- Raport nga analiza agrokimike
- Vërtetim për vreshtat e mbjella të evidentuara në regjistrin e vreshtave, i lëshuar nga njësia rajonale e ministrisë.

1.9. Përkrahje financiare për mbjellje të sipërfaqeve të reja me pemë

Përdorues

Përdorues të kësaj mase mund të jenë ekonomitë bujqësore familjare dhe personat juridik, të cilët kanë mbjellë sipërfaqe të reja me pemishte në vjeshtën e vitit 2009 dhe pranverën e vitit 2010, me këto lloje të pemëve: molla, dardha, ftonj, mushmollë, kumbulla, pjeshka, kajsi, qersh, vishnja, ara, bajame, lajthi, aktinidi, rrush serezi/stafidhe, mjedra, manaferra, lule trëndafili, luleshtrydhe, ullinj, shega, hurma, aroni dhe fiq.

Kushte për përdorim të mjeteve financiare

Minimum 0,2 ha sipërfaqe të reja të mbjella me pemishte.

Kusht obligues për kërkuesin e përkrahjes financiare është që i njëjti të ketë realizuar analizë agrokimike të tokës.

Përkrahja financiare

Shuma e përkrahjes financiare arrin në 90.000,00 denarë për hektarë.

Numri i pranueshëm i kalemave të certifikuara për mbjellje për çdo hektar është i njëjtë si atë të paraparë me masën 1.8, Tabela 8.

Dokumentet e nevojshme

Ekonomi bujqësore familjare:

- Kërkesë
- FotoFotokopje e letërnjoftimit
- FotoFotokopje e llogarisë transaksione
- Dëshmi për pronësinë ose marrjen me qira të tokës bujqësore
- Certifikatë për prejardhjen e materialit që përdorej për mbjellje (për materialin e mbjellë, të

- siguruar nëpërmjet importit)
- Fitosertifikat (për materialin e mbjellë, të siguruar nëpërmjet importit)
- Vërtetim për pastërtinë e llojit (për materialin e mbjellë që ka prejardhje vendase)
- Vërtetim për gjendjen shëndetësore (për materialin e mbjellë që ka prejardhje vendase)
- Llogari fiskale me fletëdërgesë ose faturë me fletëdërgesë për materialin e blerë për mbjellje, si dhe dëshmi për pagesën e realizuar sipas faturës
- Raport nga analiza agrokimike

Personat juridik:

- Kërkesë
- Gjendja aktuale e personit juridik, e lëshuar nga Regjistri qendror, jo më e vjetër se 6 muaj
- FotoFotokopje e llogarisë transaksione
- Dëshmi për pronësinë ose marrjen me qira të tokës bujqësore
- Certifikatë për prejardhjen e materialit që përdorej për mbjellje (për materialin e mbjellë, të siguruar nëpërmjet importit)
- Fitosertifikat (për materialin e mbjellë, të siguruar nëpërmjet importit)
- Vërtetim për pastërtinë e llojit (për materialin e mbjellë që ka prejardhje vendase)
- Vërtetim për gjendjen shëndetësore (për materialin e mbjellë që ka prejardhje vendase)
- Faturë me fletëdërgesë për materialin e blerë për mbjellje, si dhe dëshmi për pagesën e realizuar sipas faturës
- Raport nga analiza agrokimike

IV. Prodhim të materialeve për mbjellje dhe të farave

1.11 Përkrahje financiare për prodhim të farave të certifikuar vendase për drithëra, kultura industriale (përveç duhanit) dhe të kopshtarisë

Përdorues

Përdorues të kësaj mase mund të jenë ekonomitë bujqësore familjare dhe personat juridik, të cilët janë regjistruar në Regjistrin e prodhuesve të farave dhe të cilët në vitin 2010 kanë prodhuar fara.

Kushte për përdorim të mjeteve financiare

Minimum 0,3 ha sipërfaqe të mbjella për çdo kulturë në veçanti.

Përkrahja financiare

